

## Armiku i klimës në modë

Nga Gjergj Nika

Qershor 2020

Nuk e di sa është i vërtetë lajmi i mediave online, që Australia do të vrasë 10.000 deve me arsyen se qenkan një rrezik për mjedisin, sepse pijnë shumë ujë. Po e marrim si të vërtetë. Përpara se të vrasin këto kafshë të gjora nën pretekstin për të zgjidhur problemet klimatike, le të ndalojnë ose të pakësojnë garat motorrike si Formula 1, të cilat në një garë të një dite të vetme, emetojnë më shumë gaz karbonik sesa emetojnë devetë gjatë gjithë vitit.

Le të analizojmë problemet e shumta për mjedisin dhe klimën që sjellin garat motorrike, duke marrë si shembull Formula 1, që është më ndotësi nga garat motorrike dhe të shohim se sa e dëmton natyrën.

Një nga problemet e shumta për mjedisin dhe klimën, që vjen si pasojë e garave të Formula 1 është çlirimi i dioksidit të karbonit nga djegia e karburantit për një garë, e cila nuk sjell asnjë të mirë materiale për njerëzit. Kjo djegie karburanti nuk është e domosdoshme si ajo e traktorit, që punon tokën për ta mbjellur, apo e autobusit, që transporton pasagjerë nevojtarë nga një vend në një tjetër. Sipas Uikipedias një makinë e zakonshme e garës Formula 1 djeg 75 litra karburant për 100 km të përshkuara. Pra 0.75 litra karburant të djegur, lëshojnë rreth 1737 gram dioksid karboni për një kilometër, sasi kjo që është pothuajse nëntë herë më shumë se sasia e dioksidit të karbonit që lëshojnë makinat normale.<sup>1</sup> Dhe gjatë një sezoni garash, ku përdoren afërsisht 100,000 litra karburant, i takon të prodhohet 231 ton dioksid karboni për çdo makinë.<sup>2</sup> Në Formula 1 janë dhjetë skuadra, secila me nga dy makina. Vetëm karburanti i djegur për gara, pa llogaritur transportin e makinave nëpër vendet e ndryshme ku zhvillohen garat dhe mjetet e tjera ndihmëse, prodhon 463 ton dioksid karboni për çdo skuadër. Pra gjatë një sezoni të vetëm prodhohet 4630 ton dioksid karboni në total. Por mos të harrojmë se një ditë para garës (ditën e shtunë) është pole position si dhe dy trajnimet që bëhen dy ditë para garës (ditën e premte), duke i shtuar edhe stërvitjet e së cilës skuadër.

Problem tjetër për mjedisin dhe klimën, që vjen si pasojë e garave të Formula 1 është transporti nga një vend në tjetrin. Ekipet përdorin një kombinim të tre mënyrave të transportit: rrugët tokësore, ajrore dhe ujore për të transportuar makinat, pajisjet dhe personelin e tyre. Zakonisht, pjesët jo aq të rëndësishme si mjete garazhi transportohen me anë të detit. Meqenëse të

---

<sup>1</sup> <https://www.theguardian.com/environment/2007/mar/02/formulaone.sport>

<sup>2</sup> <https://co2calculator.wordpress.com/2008/11/26/ehat%E2%80%99s-the-carbon-footprint-of-a-formula-one-f1-car/>

gjitha skuadrat janë me qendër aktualisht në Evropë, transporti për garat evropiane zakonisht bëhet përmes rrugës tokësore me anë të kamionëve. Ndërsa për garat në kontinentet tjera, makinat dhe stafi, transportohen me avion në çdo vend ku bëhen garat. Ato transportohen nga avionë ngarkesash, që janë të posaçëm për transportimin e këtyre makinave, siç është Boeing 747. Sipas një studimi në 30 Prill, 2019 të Steve Hanley<sup>3</sup>, një avion Boeing 747 djeg 5 galon (19 kg) karburant për milje. Pra përdoret 5.5 milion galon (20.8198 kg) karburant vetëm për transportin e një skuadre nga një garë në tjetrën. I shtojmë kësaj edhe 25% për provat, eventet promocionale, dhe aktivitete të tjera dhe arrin gati në 7 milion galon (26.4979kg). Një gallon (3.79kg) karburant, kur digjet, prodhon 21 pond (9.525 kg) dioksid karboni. Pra, 21 pond (9.525 kg) herë 7 milion galon (26.4979kg) është e barabartë me 147 milion pond (66 678 078.4 kg) dioksid karboni, vetëm që Formula 1 të mund të sjellë "shfaqjen" për fansat në të gjithë botën. Për çdo garë përkohën rreth 110,000 milje në ajër për transportimin e makinave, pjesëve të makinave etj. të cilat peshojnë nga 50 deri në 100 ton, plus dhjetë skuadra i takon të përkohën 1,100,000 milje.<sup>4</sup> Secili ekip transporton pjesë të mjaftueshme rezervë për të rindërtuar makinat nëse dëmtohen, 40 sete gomash, 2.500 litra karburant, 200 litra vaj motorik dhe 90 litra ftohës. Dhe pastaj ka mjetet e tjera të nevojshme, kompjutera, veshje (skuadrat më të mëdha mund të mbajnë deri në 50 ton veshje) si dhe ushqim të mjaftueshëm për nja 200 vakte, plus të gjitha gjërat e nevojshme për të përgatitur ato vakte si dhe kuzhinierët personalë që udhëtojnë me ekipin.<sup>5</sup> Përveç transportit të materialeve, kemi edhe transportin e punonjësve të çdo skuadre. Vetëm një skuadër e Formula 1 përmban më shumë se 70 punëtorë, pra i takon të transportohen rreth 700 punonjës, nëse llogarisim të gjitha stafet e marra së bashku. Përveç kësaj, kemi edhe transportin e familjarëve dhe të fansave në çdo vend ku bëhen garat. Gjithë kjo peshë lëviz në 20 dhe më tepër shtete të ndryshme çdo vit.<sup>6</sup> Garat e Formula 1 fillojnë nga lindja e deri në perëndim, duke përshkruar pesë kontinente me doza kënaqësie dhe karboni për turmën e hipnotizuar. Në vitin 2019, Formula 1 ka filluar nga Australia, Bahrein, Kina, Azerbajxhan, Spanjë, Monako, Kanada, Francë, Austri, Britani, Gjermani, Hungari, Belgjikë, Itali, Singapor, Rusi, Japoni, Meksikë, USA, Brazil, e deri në Abu Dabi, pra janë bërë 21 gara. Për sezonin 2020, Formula 1 do të ketë 22 gara. Sezoni do të fillojë nga Australia, Bahrein, Vietnam, Kina, Hollandë, Spanjë, Monako, Azerbajxhan, Kanada, Francë, Austri, Britani, Hungari, Belgjikë, Itali, Singapor, Rusi, Japoni, USA, Meksikë, Brazil, e deri në Abu Dabi.<sup>7</sup> Liberty Media<sup>8</sup> ka negociuar që në të ardhmen Formula 1 të zgjerohet deri në 25 gara. Edhe pse ka shumë të

---

<sup>3</sup> Autor i faqes online Clean Technica

<sup>4</sup> <https://cleantechnica.com/2019/04/30/the-gigantic-carbon-footprint-of-formula-one/>

<sup>5</sup> <https://ëëë.ëired.com/2014/11/ship-f1-car-across-globe-36-hours/>

<sup>6</sup> Numri i shteteve ku zhvillohet Formula 1 po rritet çdo vit

<sup>7</sup> <https://ëëë.formula1.com/en/latest/article.record-breaking-22-race-f1-calendar-set-for-2020.7vdbREiAYJKP5Ey8ëhgIC2.html>

<sup>8</sup> Liberty Media zotëron Formula 1

pakënaqur me këtë ndryshim për sezonin 2020, Presidenti i Federatës Ndërkombëtare të Automobilave, Jean Todt ka kritikuar ankimet e tyre.<sup>9</sup> Me sa duket, ky sport po rritet çdo vit e më shumë, duke dëmtuar të ardhmen e planetit tonë.

Sikur, gjithë kjo energji e harxhuar vetëm për logjistikën e garave motorrike të Formula 1 mund të ishte përdorur për të nxjerrë ujë nga toka ose për të përpunuar ujin e oqeanit e për ta kthyer atë në ujë të pijshëm përmes procesit të desalinimit<sup>10</sup> ose me anë të osmozës së kundërt<sup>11</sup>, do të kishte sjellë ujë të mjaftueshëm për devetë e Australisë. Dhe sikur kjo sasi tonelatash që transportohet në ajër të ishte ujë, transporti i saj nga Evropa në Australi do të kishte ngopur devetë e Australisë, por ngop vetëm kënaqësinë e disa spektatorëve, derra të kënaqur, të hipnotizuar nga moda e korporatave, mbush xhepat e biznesmenëve gjakpirës e planetshkatërrues dhe acaron njerëzit e ndërgjegjshëm mjedisorë, sokratë të vuajtur në mbarë botën, të cilët nuk kanë impakte dhe as akses në vendimmarrjet planetare.

Problem tjetër për mjedisin që sjellin garat e Formula 1 është zënia e tokës bujqësore nga pistat. Ky sport, industri argëtimi për bosat e Formula 1, josh ndërtimin e pistave të reja duke kthyer tokat bujqësore në asfalt, i cili është burim nxehtësie, dioksidi karboni dhe gazrash të tjera serë. Sipas vitit 2007, sektori i asfaltit në përgjithësi ka emetuar 830,000 ton dioksid karboni nga prodhimi i 26 milion ton asfalt.<sup>12</sup> Emetimi i përgjithshëm i CO<sub>2</sub>e<sup>13</sup> për ndërtimin e 20 km asfalt është 52,264,916.06 kg. Për ndërtimin e asfaltit, faza e përzierjes gjeneron sasinë më të madhe të emetimeve të gazrave globale, duke përbërë 54% të totalit. Prodhimi i lëndës së parë përbën 43% të emetimeve totale të gazrave globale.<sup>14</sup> Mesatarja e gjatësisë së pistave për zhvillimin e garave me makina Formula 1 është 4.3 deri në 5.9 km, pra do të thotë afërsisht një hektar tokë e asfaltuar për çdo vend pritës të garave të makinave, tokë e cila mund të ishte përdorur për ferma ose pyllëzim të këtij planeti, i cili po zhveshet çdo ditë, pa llogaritur pjesën e zënë nga ofiçinat e stadiumet. Pista më e shkurtër është ajo e Monakos 3.337 km, kurse më e gjata është ajo e Peskarës 25.800 km. Aktualisht numërohen 21 pista, që përdoren çdo vit për zhvillimin e garave të Formula

<sup>9</sup> <https://ëëë.autosport.com/f1/neës/147939/f1-shouldnt-moan-about-expanding-calendar--todt>

<sup>10</sup> Desalinimi ose desalinizimi i referohet një prej disa proceseve që heqin kripën e tepërt dhe mineralet e tjera nga uji në mënyrë që të përftohë ujë i freskët i përshtatshëm për konsum të kafshëve ose ujitje, dhe nëse hiqet pothuajse e gjithë kripa, për konsum njerëzor, ndonjëherë prodhon kripë tryeze si një nënprodukt.

<sup>11</sup> Osmoza është procesi i depërtimit të tretësit nga tretja me dendësi më të vogël në tretje me dendësi më të madhe, nëpërmjet membranës gjysëm depërtuese. Membrana e lëshon vetëm tretësin duke i mbajtur materiet e tretura. Kjo ndodh për shkak të presionit osmotik që krijohet në periferi të tretjes, si pasojë e dallimeve në dendësi, aq më më e madhe është shtypja osmotike. Gjatë procesit të kundërt të osmozës, tretësi rrjedh përgjatë membranës, ndërmjet shtresave të saja. Gjithnjë duke e shtypur sipërfaqen kalon përmes shtresave gjysmëdepërtuese të membranës, duke i lenë substancat e tretura në tretjen e dendur (uji i ndotur). Uji që rrjedh përgjatë membranës e mundëson punën e sistemit dhe e pengon ndotjen e ujit tanimë të pastruar.

<sup>12</sup> <https://ëëë.carbontrust.com/media/206468/ctg020-asphalt-industrial-energy-efficiency.pdf>

<sup>13</sup> Equivalenti i dioksidit të karbonit (CO<sub>2</sub>e) është një term për përshkrimin e gazrave të ndryshëm serë. CO<sub>2</sub>e nënkupton sasinë e CO<sub>2</sub> e cila ka ndikim ekuivalent të ngrohjes globale.

<sup>14</sup> <https://ëëë.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC4809014/>

1, por janë edhe pistat joaktive, të cilat nuk përdoren çdo vit. Që kur ka filluar Formula 1 deri sot, 71 pista janë përdorur vetëm për garat e Çmimit të Madh. Janë të shumta pistat e garave që ekzistojnë në mbarë botën, disa prej të cilave përdoren edhe për gara të tjera motorrike përveç Formula 1: A1-Ring, Adelaide Street Circuit, Ain-Diab Circuit, Aintree Motor Racing Circuit, Anderstorp Raceëay, AVUS, Bahrain International Circuit, Baku City Circuit, Circuito da Boavista, Brands Hatch, Circuit Bremgarten, Buddh International Circuit, Canadian Tire Motorsport Park, Circuit de Barcelona-Catalunya, Circuit de Charade, Circuit of the Americas, Detroit street circuit, Dijon-Prenois, Donington Park, Autodromo Enzo e Dino Ferrari, Circuito do Estoril, Fair Park, Fuji Speedëay, Circuit Gilles Villeneuve, Autódromo Hermanos Rodríguez, Hockenheimring, Hungaroring, Indianapolis Motor Speedway, Intercity Istanbul Park, Circuito del Jarama, Circuito de Jerez, Autódromo José Carlos Pace, Autódromo Juan y Oscar Gálvez, Korea International Circuit, Kyalami, Circuit de la Sarthe, Long Beach Street Circuit, Circuit de Nevers Magny-Cours, Marina Bay Street Circuit, Melbourne Grand Prix Circuit, Circuit de Monaco, Circuito de Monsanto, Circuit Mont-Tremblant, Montjuïc circuit, Autodromo Nazionale di Monza, *Mosport Park*, Autódromo Internacional Nelson Piquet, Nivelles-Baulers, Nürburgring, Okayama International Circuit, *Österreichring*, Circuit Paul Ricard, Pedralbes Circuit, Pescara Circuit, Phoenix street circuit, Port Imperial Street Circuit, Prince George Circuit, Red Bull Ring, Reims-Gueux, Riverside International Raceëay, Rouen-Les-Essarts, Sebring International Raceëay, Sepang International Circuit, Shanghai International Circuit, Silverstone Circuit, Sochi Autodrom, Circuit de Spa-Francorchamps, Suzuka International Racing Course, Valencia Street Circuit, Ëatkins Glen International, Yas Marina Circuit, Circuit Zandvoort, Zeltueg Air Base, Circuit Zolder.<sup>15</sup>

Përveç këtyre ka edhe shumë pista të tjera dhe vazhdojnë të ndërtohen pista të reja vetëm për gara motorrike, duke zënë kështu toka bujqësore e pyjore. Në tetor të vitit 2011 projekti për të ndërtuar pistën e re Buddh International Circuit detyroi qindra njerëz të varfër në Indi të largohen nga shtëpitë e tyre. Pas dy garash, Çmimi i Madh i Indisë u anulua,<sup>16</sup> gjithë ky investim i pavlerë na la si trashëgim një tokë që ishte pjellore, tani të betonizuar, e cila më parë prodhonte ushqim dhe oksigjen për njerëzit e tani nuk prodhon asgjë. Megjithë shumë përpjekjeve të ish-pronarëve të varfër të tokës për ta rimarrë tokën e tyre, tani të kthyer në pistë, për ta ribërë tokë buke e për të banuar aty, atyre nuk iu rikthye toka, dhe ky asfalt mbeti si pllakë varri mbi bimësinë.

Problem tjetër për mjedisin që sjellin garat e Formula 1 është edhe konsumimi i gomave.<sup>17</sup> Çdo pilot ka në dispozicion 12 sete gomash vetëm për një garë,<sup>18</sup> pa llogaritur pole position dhe

---

<sup>15</sup> [https://en.ëikipedia.org/ëiki/Category:Formula\\_One\\_circuits](https://en.ëikipedia.org/ëiki/Category:Formula_One_circuits)

<sup>16</sup> <https://cleantechnica.com/2019/04/30/the-gigantic-carbon-footprint-of-formula-one/>

<sup>17</sup> Gomat konsumohen si pasojë e fërkimit me pistën

<sup>18</sup> <http://en.espn.co.uk/f1/motorsport/page/3710.html>

trajnimet e stërvitjet e së cilës skuadër; goma të cilat prodhohen nga nafta dhe konsumohen brenda ditës, duke krijuar kështu mbetje. Gomat e Formula 1 janë ndërtuar për performancën dhe jo për jetëgjatësinë. Gomat e makinave të zakonshme zgjasin rreth 15,000 km, por jeta e një gome të Formula 1 është midis 60 dhe 120 km. Meqenëse gomat janë të ndërtuara për performancë ekstreme me shpejtësi të lartë, ato konsumohen shumë shpejt.<sup>19</sup>

Po kështu, si Formula 1, problem për mjedisin janë edhe garat e tjera, që emetojnë dioksid karboni dhe gazra të tjera, dhe po ashtu dëmtojnë mjedisin dhe klimën, gara si NASCAR, Rally Dakar, Moto GP, Formula 3, Formula Ford, Formula Renault, Indianapolis 500 e shumë gara të tjera makinash e motorrash. Përveç dëmeve ekologjike, sporte të tilla si garat motorrike, shpeshherë çojnë edhe në vdekjen e pilotëve ose gjymtimin e tyre të përjetshëm (duke u bërë barrë për shoqërinë).

Askush nuk e ngre zërin kundër këtyre garave me makina. Nëse bëjmë kërkime në google për dëmet mjedisore që shkaktojnë këto makina, ka më shumë propagandë sikurse këto makina do të bëhen ekologjike, sesa informacione të nevojshme të vërteta sa dëme i shkaktojnë natyrës dhe sa gazra serë çlirojnë, duke dhënë informacione vetëm për dioksidin e karbonit dhe jo për gazrat e tjera që çlirojnë garat motorrike. Pse askush nuk flet kundër këtyre garave motorrike, por të gjithë bëjnë shou duke sharë apo akuzuar ndonjë subjekt, që është etiketuar si armik i klimës dhe është në modë për t'u sharë, apo flasin kundër ndonjë kompanie private pa lidhje, sikur na dëmtoka mjedisin e na qenka problemi i gjithë planetit. Pse nuk i dalin kundër këtij kanceri multinacional siç janë garat motorrike.

Siç u pa më lart, vërtet armiku i jonë janë këto gara motorrike, të cilat na dëmtojnë nga ana ekologjike tokat pyjore e bujqësore, dhe nga ana financiare duke u marrë para e toka të varfërve për të ndërtuar pista. Po ashtu dëmtojnë edhe popullin sportdashës budalla të këtij sporti duke u shitur bileta. Po ashtu përfitojnë kompanitë edhe nga publicitetet në programet televizive. Ky studim është marrë më shumë me Formula 1, sepse është më e ndjekura, më shkaktuesja e problemeve që përmendëm më lart, e cila pasohet nga ndotës të tjerë të mjedisit si: NASCAR, Rally Dakar, Moto GP, Formula 3, Formula Ford, Formula Renault and Formula Palmer Audi, Indianapolis 500 e shumë gara të tjera makinash e motorrash. Duke arritur në përfundimin se garat motorrike janë më shkatërruese se devetë, u bëj thirrje të mos vrisni devetë, por pakësoni garat motorrike! Problem për klimën janë kauzat që na parapërcaktohen nga disa njerëz, të maskuar si dashamirës të natyrës, pra këto kauza janë në modë. Por ka edhe mjedisorë të vërtetë, dashamirës të natyrës, që janë të shtrejtë në krunde dhe të lirë në miell. Ne nuk duhet të harxhojmë kohën duke u marrë me gjëra të vogla

---

<sup>19</sup> <https://ëëë.deccanherald.com/sports/formula-1/lasting-little-60km-tyres-are-716735.html>

duke lënë pas dore gjërat e rëndësishme. Shumë beteja mjedisore janë fituar, por beteja kundër Formula 1, qëllimisht është lënë pas dore.

Për ta mbyllur me një apel të qartë: Kush ka ndikim ta shfrytëzojë ndikimin e vet për t'i ndaluar ose pakësuar këto gara motorrike; kush nuk ka ndikim, mund të fillojë me bojkotimin e televizioneve, që kanë blerë të drejtën televizive për t'i shfaqur këto gara, të mos i ndjekë këto gara, të mos i reklamojë dhe as të mos blejë biletën për t'i ndjekur këto gara motorrike si dhe të shfaqë neveri dhe mospërfillje për personat që e ndjekin këtë sport, qofshin të afërm, miq, shokë, kolegë etj., duke i bërë kështu kundrapublicitet kësaj industrie gjakpirëse. Dhe kush të ketë mundësi, në një të ardhme të afërt të kalojë në aktiv duke filluar me protesta kundër këtyre garave në vendet ku zhvillohen, deri në arritjen e objektivit tonë, i cili është t'i ndalojmë ose t'i pakësojmë këto gara motorrike për të mirën e natyrës dhe të njerëzimit. Unë ndokujt mund t'i dukem kundra rrymës me këtë apel, sepse është pasioni i disa njerëzve, të cilët shpenzojnë para për ta mbajtur në këmbë këtë industri gjakpirëse, siç është pasioni im për të qëndruar në natyrë. Por nëse nuk mund t'i ndaloni, të paktën pakësoni garat motorrike! Nëse pasioni im për të qëndruar në natyrë nuk është i dëmshëm, pasioni i tyre i pandërgjegjshëm po dëmton natyrën dhe të ardhmen e planetit.